



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 174/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Vlastimir Dimić kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kaçanik, për shkak të vendosjes së posterit në objekte publike, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 18.06.2012, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 14.06.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se me datën 14 Qershor 2012, në rrugën "Agim Bajrami", në Kaçanik, rreth orës 16:00, militantë të PDK-së, kanë vendosur posterë të kandidatit të tyre për kryetar të Kaçanikut, Besim Ilazi në kala të qytetit. Parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik PDK, ka bërë shkelje të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, të *Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, neni 3 paragrafi 1 pika (b), si dhe neni 33 paragrafi 1 pika (b), i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP)*, në atë mënyrë që sipas parashtruesit të ankesës është bërë vendosja e postereve të kandidatit të subjektit politik të PDK-së, në objekte publike .

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 15.06.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 16.06.2012, në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar në shkresën Nr.174/2, PZAP-i, pranoi përgjigje në ankesë nga subjekti politik PDK, në të cilën theksohet se: Subjekti politik PDK në Kaçanik nuk e ka shkelur asnjë rregull zgjedhore dhe se pretendimet e LVV-së nuk vërtetohen asgjë, sepse posteret e tanë nuk janë vendosur në asnjë vend të ndaluar, më tutje subjekti politik PDK në përgjigjen në ankesë thekson se argumentet

të cilat i ka parashtruar LVV, nuk janë objekte ku ndalohet vendosja e posterave, andaj këto janë vetëm trillime.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar, nga subjekti politik LVV, pretendohet se nga militantë të subjektit politik PDK, është vendosur posteri i kandidatit të tyre për kryetarë komune të Kaçanikut në objekt publik. PZAP-i gjeti se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë ngase fotografit e bashkangjitura në shkresat e lëndës nuk janë dëshmi të asaj natyre që do ti vërtetonin pretendimet e theksuara në ankesë. Pasi që nga fotografitë që gjendet në shkresat e lëndës nuk mund të identifikohet objekti, për të cilin pretendohet se është objekt publik apo se mund të jetë kalaja e qytetit. Prandaj një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i pabazë, andaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

Anr. 174/2012 më datën 18.06.2012.

